



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____ . Data: **23.05.2025.**

Mitrovicë Veriore.

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA E KOSOVË	
KOMUNA MITROVICË VERIORE OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
Njësia Org.	10
Org. Jodir.	10-030/01-0008225/25
Org. Unit.	
Nr. i Fëmijëve	2
Si Shprehjet	26.05.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 17 paragrafi 1 pika c dhe nenit 40 paragrafi 2 pika l) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 25 paragrafi 3 dhe 6 i Ligjit 06/L-92 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 29 të rregullores (QRK) nr. 09/2020, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4 dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 1.3, të Statutit të Komunës Mitrovicë Veriore me nr. 10-030/01-0007269/24 të datës 28/06/2024, Propozim-Vendimit Nr. 01-030/01-0008126/25 të datës 23.05.2025 të Kryetarit të Komunës, Konfirmimit të ligjshmërisë së Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik-Ndërtimin e Qerdhes për fëmijë me Nr.020-303/3 të datës 20.05.2025, Raportit të vlerësimit Nr.168-1/2025 të datës 23.05.2025 të Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të MFPT, Kuvendi i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për këmbimin e pronës së paluajtshme dhe financimin si dhe ndërtimin e Qerdhes Publike për fëmijë)

- 1. APROVOHET** Propozimi i Kryetarit të Komunes për këmbimin e pronave të paluajtshme dhe financimin si dhe ndërtimin e Qerdhes Publike për fëmijë.
- 2. Me këtë Vendim këmbehen** pronat e paluajtshme si në vijim:

2.1 Pjesa e parcelës, në sipërfaqe prej 750.00 m² (shtatëqind e pesëdhjetë metra katror) e cila ndahet nga parcela kadastrale P-73808130-00267-3, Komuna Mitrovicë Veriore, ZK Mitrovicë Veriore, ZKK Mitrovicë Veriore, lloji i njësisë parcelë, vendi i quajtur Makedonska, sipërfaqja 2132.00 m² (dymijë e njëqind e tridhjetë e dy metra katror), pronë private, me bashkëpronar Enver Aliu me 6/43 të pjesës së pronësisë dhe Kompania e sigurimeve “Eurosig” SH.A. me 37/43 të pjesës së pronësisë.

DO TË KËMBEHET:

Me pjesën e parceles në sipërfaqe prej 111 m² (njëqind e njëmbëdhjetë metër katror) e cila do të ndahet nga parcela kadastrale: P-73808130-0267-1, Komuna Mitrovicë Veriore, Zona Kadastrale Mitrovicë Veriore, Zyra Kadastrale Komunale Mitrovicë Veriore, lloji i njësisë parcelë, vendi i quajtur Makedonska, Pronari Komuna e Mitrovicës Veriore, nr personal 601621776, me 1/1 e pjesës së pronësisë dhe sipërfaqe prej 120 m². dhe

Me parcelën kadastrale: P-73808130-0267-9, Komuna Mitrovicë Veriore, Zona Kadastrale Mitrovicë Veriore, Zyra Kadastrale Komunale Mitrovicë Veriore, lloji i njësisë parcelë, vendi i quajtur Makedonska, Pronari Komuna e Mitrovicës Veriore, nr personal 601621776, me 1/1 e pjesës së pronësisë dhe sipërfaqe prej 639 m².

2.2 Si pjesë e këtij këmbimi Kompania e sigurimeve Eurosig SH.A dhe Enver Aliu i ofrojnë Komunës së Mitrovicës Veriore ndërtimin e një Qerdhe Publike e cila do të jetë në nivelin e Përdhësës duke përfshirë të gjitha elementet e ndërtimit siq janë: planin e Arkitekturës (Eksterier & Interier), ndërtimin e vrazhdë, ndërtimin e mureve, izolimin e mureve me material që i rezistojnë zhurmes, të ftohtit, të nxehtit, suvatimin, fasadimin, lysterjen, sistemin e ajrimit (ventilimit), vendosjen e dymave dhe dritareve të standarteve të larta, shpërndarjen dhe instalimin në rrjetin e ujsjellsit, kanalizimit, energjisë elektrike si dhe kyqjen e tyre në rrjetet përkatëse publike, rregullimin e oborrit të qerdhes me kubëzime dhe hapsirave të gjelbërta, vendosjen e lodrave për fëmijë sipas standardeve të kërkuara nga Drejtoria për Arsim dhe të gjitha pjesëve ndërtimore me të gjitha elementet të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës deri në pranimin teknik për ta bërë një qerdhe funksionale sipas kritereve të Drejtorisë për Arsim dhe të Ministrisë së Arsimit.

2.3 Poashtu Pronarët Kompania e sigurimeve Eurosig SH.A dhe Enver Aliu i ofrojnë Komunës së Mitrovicës Veriore inventarizimin e komplet Qerdhes me të gjitha elementet që janë të nevojshme për inventarizim deri në detalajet më të thjeshta gjithnjë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga Drejtoria për Arsim dhe Ministria e Arsimit.

2.4 Ndërtimi i Qerdhes me të gjitha detalet e lartëcekura do të përfundojë brenda periudhës prej dy vitesh duke filluar nga momenti i marrjes së lejes së ndërtimit.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Arsim.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

Mitrovicë Veriore

Nedžad UGLJANIN

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

Dorëzohet:

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPI.

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës dhe të gjitha drejtorive



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Erden Atiq, Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore Nedžad Ugljanin, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ramadan Potera, Zyrtar për Monitorim të Komunave
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim

Data:
28.05.2025
Nr. 020-303/4

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 10-030/01-0008225/25, për këmbimin e pronës së paluajtshme dhe financimin si dhe ndërtimin e qerdhes publike për fëmijë.

I miratuar më datë: 26.05.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.05.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

Arsyetim

Vendimi Nr. 10-030/01-0008225/25, për këmbimin e pronës së paluajtshme dhe financimin si dhe ndërtimin e qerndhes publike për fëmijë.

MAPL konstaton se akti i miratuar nga kuvendi i komunës së Mitrovicës Veriore, është bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 paragrafi 3 dhe 6, nenit 25 paragrafi 1, 2, 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 29 të Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimi është miratuar në mbledhjen e kuvendit të komunës së Mitrovicës Veriore e mbajtur me datë 23.05.2025, i miratuar me vota unanime.

Neni 14 paragrafi 14.2 e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale sqaron se: Komunitat kanë të drejtë të shesin dhe japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

Bazuar në dispozitën e lartshënuar në rastet kur prona e komunës është vlerësuar me çmim më të lartë nga Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, personi fizik apo juridik diferencën nuk mund të e kompensoj me mjete financiare.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.